

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**

Nr. i prokurimit	KEK-26-1179-1-1-1
Nr. i brendshëm	KEKO-26-66-1-1-1

Sa i përket tenderit për: **Furnizim me pjesë ndërrimi dhe servisimi për mekanizmin e rëndë Komatsu**

ANKESË

Identifikimi i ankuesit*

Emri i Kompanisë: **Bahri Asllani B.I - N.T.SH "EKOINVEST"**

Adresa : **Rruga "Agim Ramadani", Nr. 511/9, Prishtinë, 10 000**

Numri Telefonit: **044/303-068**

Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj: **Eron Asllani**

Adresa elektronike: **info@ekoinvest.co**

Data e parashtrimit të ankesës: **20.05.2026**

Nënshkrimi dhe vula: _____



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” apo “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

- **B05- Njoftimi për kontrate: 24.03.2026;**
- **Afati për dorëzim të tenderit: 25.05.2026;**
- **Kriteret e dhënies: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët**
- **Paraqitja e Kërkesës për Rishqyrtim- 18.05.2026**
- **Përgjigje në Kërkesës për Rishqyrtim – 19.05.2025**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	<input type="checkbox"/>					Jo	<input checked="" type="checkbox"/>	
----	--------------------------	--	--	--	--	----	-------------------------------------	--

--

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	<input type="checkbox"/>				Jo	<input checked="" type="checkbox"/>	
----	--------------------------	--	--	--	----	-------------------------------------	--

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Me datën 18.05.2026 përmes platformës së E- Prokurimit kemi dërguar Kërkesën për Rishqyrtim të Autoriteti Kontraktues – **KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a.** . Me datën 19.05.2026 përmes platformës së E- Prokurimit kemi pranuar përgjigjeje – Autoriteti nuk shqyrton Kërkesën për Rishqyrtim pasi e cilëson si të jashtë afatshme.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92, (LPP), janë:

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 108/A - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Shkeljet e dispozitave të RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, janë:

Neni 60 - Paraqitja e kërkesës për rishqyrtim dhe afatet kohore

Neni 63 - Vendimi i Autoritetit Kontraktues,

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me këtë ankesë kundërshtojmë në tërësi njoftimin/vendimin e Autoritetit Kontraktues – Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A., të datës 19.05.2026, përmes të cilit kërkesa jonë për rishqyrtim është cilësuar si jashtë afatit ligjor dhe nuk është shqyrtuar në themel. Ky vendim është faktikisht i pasaktë dhe juridikisht i pabazuar, sepse AK ka llogaritur afatin mbi bazën e datës 18.05.2026, ndonëse kjo datë nuk ishte më afati i vlefshëm dhe operativ i Aktivitetit të Prokurimit.

Në rastin konkret, pas Kërkesës për Rishqyrtim të paraqitur nga një Operator tjetër Ekonomik, AK më datë 13.05.2026 ka nxjerrë vendim me të cilin ajo kërkesë është aprovuar pjesërisht si e bazuar. Pas këtij vendimi, AK ka publikuar formularin B54 “Njoftim për informata shtesë ose përmirësim i gabimit”, përmes të cilit afati për dorëzim të tenderëve është caktuar në datën 25.05.2026, ora 12:00. Rrjedhimisht, nga momenti i publikimit të B54, afati zyrtar për dorëzim të ofertave nuk ishte më 18.05.2026, por 25.05.2026.

Duke u bazuar në këtë afat të ri zyrtar, ne kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së më datë 18.05.2026, lidhur me paqartësitë dhe mospërputhjet në dokumentet e tenderit dhe në specifikimet teknike. Kërkesa është dorëzuar brenda afatit ligjor, sepse sipas Nenit 108/A të LPP-së dhe Nenit 60.1 të Rregullores për Prokurimin Publik, kur kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose dokumentet e tenderit, ajo paraqitet së paku pesë ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave, ndërsa dita e dorëzimit të ofertave konsiderohet dita 0. Në këtë rast, data 25.05.2026 është dita 0, ndërsa dita e pestë para afatit është 20.05.2026. Prandaj, kërkesa jonë e dorëzuar më 18.05.2026 është paraqitur brenda afatit dhe madje më herët se minimumi i kërkuar.

Arsyetimi i AK-së se “data e fundit për dorëzimin e ofertave ka qenë 18.05.2026” bie në kundërshtim të drejtpërdrejtë me B54 të publikuar nga vetë AK. Një Autoritet Kontraktues nuk mund të publikojë një afat të ri zyrtar për dorëzim të ofertave dhe pastaj ta mohojë efektin juridik të këtij afati kur Kërkesa paraprake për Rishqyrtim është aprovuar dhe nuk është refuzuar.

Po ashtu, AK gabimisht është mbështetur në përjashtimin e Nenit 60.1 të Rregullores, sipas të cilit afati pesëditor nuk aplikohet kur AK bën zgjatje të afatit pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1. Ky përjashtim nuk vlen në rastin konkret, sepse këtu nuk kemi zgjatje pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim, por kemi zgjatje pas aprovimit të pjesëshëm të një kërkesë për rishqyrtim. Për këtë situatë zbatohet dispozita e Nenit 63.1.3 të Rregullores, sipas të cilit kur kërkesa lidhur me njoftimin ose dokumentet e tenderit miratohet plotësisht ose pjesërisht, AK publikon B54 dhe zgjat afatin për dorëzim të tenderëve. Pikërisht kjo edhe ka ndodhur në këtë aktivitet prokurimi. Prandaj, AK ka bërë interpretim të gabuar që nuk aplikohet në këtë rast.

Me këtë veprim, AK ka bërë shkelje të Nenit 108/A të LPP-së, Nenit 60.1 dhe Nenit 63.1.3 të Rregullores për Prokurimin Publik, si dhe ka cenuar parimet themelore të LPP-së për transparencë, trajtim të barabartë, konkurrencë efektive dhe mjet juridik efektiv. Shkelja nuk është thjesht formale; ajo ka pasojë të drejtpërdrejtë procedurale, sepse kërkesa jonë nuk është refuzuar për shkak të pabazueshmërisë së pretendimeve, por është larguar nga shqyrtimi mbi një bazë të gabuar juridike. Për me keq, pretendimet tona argumentojnë gabimet/mungesat në specifikimin teknik të cilat nëse nuk permiresohen/plotesohen në këto faze do të shkaktojnë pamundësim të pjesëmarrjes në këtë Aktivitet të Prokurimit.

Për më tepër, interpretimi i AK-së krijon një pasojë juridikisht të papranueshme: operatorëve ekonomikë u kërkohet të përgatisin oferta sipas afatit të ri 25.05.2026, por njëkohësisht u mohohet e drejta të paraqesin kërkesë për rishqyrtim duke u bazuar në të njëjtin afat.

Për shmangie të çdo dyshimi, ne si OE ankues theksojmë se pretendimet materiale të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim të datës 18.05.2026 mbeten në tërësi në fuqi dhe kërkohet që të shqyrtohen nga OSHP. Këto pretendime kanë të bëjnë me mospërputhje dhe paqartësi në listën teknike të pjesëve të kërkuara në Aneksin 1, përfshirë raste ku disa kode nuk janë numra pjesësh por faqe katalogu, disa numra pjesësh nuk ekzistojnë, disa pjesë nuk furnizohen më si artikuj individualë dhe disa artikuj varen nga modeli, numri serik ose konfigurimi i makinerisë. Këto çështje pamundësojnë ofertim të saktë, krahasues dhe të përgjegjshëm, si dhe cenojnë konkurrencën e barabartë ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Pretendimi 1 - Lista teknike dhe kërkesat dokumentare janë të paqarta, joproportionale dhe krijojnë pamundësi objektive për ofertim të përgjegjshëm

Ne, si përfaqësues të autorizuar të prodhuesit Komatsu për Kosovë, po ua percjellim komentet e pranuar nga prodhuesi të cilat kanë konstatuar se për një pjesë e pozicioneve në listën teknike (excel-i i bashkëngjitur), numrat e pjesëve - PART NUMBERS janë gabim, nuk janë të identifikueshme, nuk janë të furnizueshme në formën e kërkuar, ose kërkojnë informacione shtesë të domosdoshme para se të mund të ofertojnë saktë.

Kjo nuk është çështje formale, por çështje thelbësore teknike. Numri i saktë i pjesës, modeli i makinerisë, numri serik, konfigurimi i makinerisë dhe informacioni nëse pjesa kërkohet si artikull individual, asamble apo grup zëvendësues, janë të dhëna të domosdoshme për të përcaktuar përputhshmërinë teknike, çmimin, afatin e liferimit dhe garancionin e produktit.

Nga sqarimet teknike të bashkangjitura si **Shtojca 1 – Attachmend.xlsx**, rezulton ndër të tjera se:

- disa kode nuk janë numra pjesësh, por faqe katalogu, si p.sh. **K0210-05A0** dhe **R2100-04A0**;
- disa numra pjesësh nuk ekzistojnë ose duhet të verifikohen, si p.sh. **421-43-48511**, **207-01-K2030**, **6117-11-8830**, **01010-82096** dhe **600-31-4500**;
- disa pjesë nuk furnizohen më si artikuj individualë ose kërkojnë zëvendësim teknik, si p.sh. **600-311-3600**, **6251-61-1100**, **56D-22-12611** dhe **707-02-X7830**;
- disa pjesë varen nga modeli, numri serik ose konfigurimi i makinerisë, si p.sh. **424-22-27411**, **6743-61-1531**, **AN51500-10770** dhe **714-23-15600**;
- disa pjesë mund të ofrohen vetëm si asamble ose si “replaceable group parts”, si p.sh. **207-30-78010** → **207-30-00651** dhe **708-2G-01070** → **grup zëvendësues**.

Këto të dhëna tregojnë se lista teknike nuk është e mjaftueshme për ofertim të saktë. Pa korrigjimin e tyre, operatorët ekonomikë nuk mund të kalkulojnë realisht çmimin, nuk mund të përcaktojnë saktë pjesën që duhet furnizuar dhe nuk mund të garantojnë përputhshmërinë teknike.

Sipas LPP-së, Dosja e Tenderit duhet të përmbajë informatat përkatëse dhe të gjitha termet materiale që i mundësojnë operatorit ekonomik të përgatisë ofertë të përgjegjshme. Po ashtu, specifikimet teknike duhet të jenë të qarta, të sakta, të lidhura me qëllimin e prokurimit dhe të mos krijojnë kufizim apo diskriminim ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Në rastin konkret, AK kërkon katalogë, pjesë katalogu dhe vizatime teknike për artikujt e ofruar, ndërsa lista përmban numër shumë të madh pozicionesh dhe një pjesë e tyre, sipas verifikimit të prodhuesit, janë të pasakta, të paidentifikueshme, të pafurnizueshme ose varen nga të dhëna shtesë. Kjo e zhvendos padrejtësisht barrën e saktësisimit të specifikimit nga AK tek operatorët ekonomikë dhe krijon rrezik që ofertuesit të interpretojnë ndryshe të njëjtat pozicione.

Për pasojë, vlerësimi i ofertave mund të bëhet arbitrar ose diskriminues: një operator mund të ofrojë artikull individual, një tjetër asamble, një tjetër grup pjesësh zëvendësuese, ndërsa një tjetër mund të eliminohet për mungesë dokumentacioni për një pjesë që në fakt nuk ekziston ose nuk furnizohet në formën e kërkuar. Kjo cenon parimet e konkurrencës, trajtimit të barabartë, transparencës dhe proporcionalitetit.

Për më tepër, kërkesa për dorëzimin e katalogëve/vizatimeve për çdo pozicion, pa specifikuar paraprakisht se cilat pozicione janë teknikisht të sakta dhe cilat kërkojnë verifikim, e bën

përgatitjen e ofertës praktikisht të pamundur ose joproporcionale. Një kërkesë më e drejtë dhe më funksionale do të ishte dorëzimi i tabelës së referencave OEM/prodhuesit dhe dokumentacioni teknik vetëm për pozicionet ku ofrohet ekuivalent ose ku AK ka dyshim të arsyeshëm për baras vlefshmërinë.

Pretendimi 2 – Vlera e ulët e parashikuar e kontratës

Në Dosjen e Tenderit është përcaktuar vlera e parashikuar prej 960,000.00 EUR për periudhë 36 mujore. Nga krahasimi me aktivitetin paraprak të vitit 2021, rezulton se vlera/buxheti ka mbetur relativisht i njëjtë, ndërsa çmimet e tregut për pjesë rezervë, transport ndërkombëtar, dogana, inflacion, kosto të prodhimit dhe afatet e furnizimit kanë ndryshuar ndjeshëm. Po ashtu, sasia dhe numri i pozicioneve/artikujve është rritur.

Sipas LPP-së, vlera e parashikuar duhet të llogaritet mbi bazën e çmimit përfundimtar që pritet të paguhet nga AK për të gjitha produktet, shërbimet dhe kostot e parashikueshme në ditën e dërgimit të njoftimit për kontratë. Në këtë rast, vlera e parashikuar nuk duket të jetë rezultat i një hulumtimi real dhe të përditësuar të tregut, por përsëritje e buxhetit të mëhershëm, pa reflektuar rritjet objektive dhe zgjerimin e objektit të furnizimit.

Kjo krijon rrezik për ofertim jo real, eliminim të operatorëve seriozë, paraqitje të ofertave jo-normalisht të ulëta ose pamundësi të realizimit të kontratës me çmime reale të tregut. Një vlerë e tillë e nënvlerësuar nuk siguron ekonomicitet dhe efikasitet, por e dëmton konkurrencën dhe mund të shkaktojë dështim të procedurës ose ekzekutim problematik të kontratës.

Me mirësjellje kërkojmë nga AK të rishikojë vlerën e parashikuar mbi bazën e analizës aktuale të tregut, rritjes së çmimeve, kostove të importit/transportit dhe shtimit të sasisë/pozicioneve

Nëse AK nuk i korrigjon paqartësitë e mësipërme, operatorët ekonomikë nuk mund të përgatisin oferta të krahasueshme dhe të përgjegjshme, ndërsa procedura rrezikon të prodhojë eliminime të padrejta, vlerësim jo objektiv dhe ekzekutim problematik të kontratës. Për këtë arsye, kërkojmë aprovimin e plotë të kësaj kërkesë dhe ndryshimin e Dosjes së Tenderit në pajtim me pretendimet e ngritura.

Pretendimet materiale të mësipërme nuk janë pretendime të reja, por janë pjesë e së njëjtës kërkesë për rishqyrtim të datës 18.05.2026, të cilën AK gabimisht nuk e ka shqyrtuar. Për këtë arsye, kërkojmë që OSHP t'i marrë në shqyrtim edhe këto pretendime, ose ta urdhërojë AK-në që t'i shqyrtojë ato në themel, në pajtim me LPP-në, Rregulloren për Prokurimin Publik dhe parimet e transparencës, barazisë në trajtim dhe konkurrencës efektive.

Duke pasur parasysh sa më sipër, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që ta aprovojë këtë ankesë si të bazuar, të konstatojë se kërkesa jonë për rishqyrtim e datës 18.05.2026 është dorëzuar brenda afatit ligjor, të anulojë njoftimin/vendimin e AK-së të datës 19.05.2026 dhe të urdhërojë AK-në që ta shqyrtojë kërkesën tonë për rishqyrtim në themel, me arsyetim të plotë faktik dhe juridik. Në alternativë, kërkojmë që OSHP vetë t'i shqyrtojë pretendimet materiale të ngritura në kërkesën tonë për rishqyrtim. Gjithashtu kërkojmë pezullimin e vazhdimin të aktivitetit të prokurimit deri në vendosjen përfundimtare mbi këtë ankesë.

Bazuar ne faktet e prezantuara me larte, Kërkojmë nga AK qe ankesa jone te aprovohet si tërësisht e bazuar dhe te merret:

V E N D I M

APROVOHET Kërkesa e Operatorit Ekonomike N.T.SH EKOINVEST (Bahri Asllani B.I.) – Prishtine për Rishqyrtimin e VENDIMIT te Autoritetit Kontraktues me nr. prokurimit KEK-26-1179-1-1-1 (KEKO-26-66-1-1-1) titulli i kontratës i dhënë nga Autoriteti Kontraktues: “Furnizim me pjesë ndërrimi dhe servisimi për mekanizmin e rëndë Komatsu”. ANULOHET (PRISHET) VENDIMI i atakuar me këtë kërkesë (i përshkruar si me larte).

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Nuk janë definuar deri me tani.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

1. B05- Njoftimi për kontrate- 16.08.2024
2. Dëshmia 1_ Vendimi i AK-së i datës 13.05.2026 për Kërkesën paraprake për Rishqyrtimi
3. Dëshmia 2_ Formulari B54 me të cilin afati është ndryshuar nga 18.05.2026 në 25.05.2026
4. Dëshmia 3_ Kërkesa jonë për Rishqyrtim e datës 18.05.2026
5. Dëshmia 4_ Njoftimi/vendimi i AK-së i datës 19.05.2026
6. Dëshmia 5_ Attachmend

Dëshmi Transaksioni

Proof of Transaction



Raiffeisen
BANK

Member of RBI Group

Të dhënat e urdhëruesit / Orderer details

Emri i urdhëruesit / Ordering Customer	BAHRI ASLLANI B.I.
Numri i llogarisë së urdhëruesit / Ordering account number	1501001010933350
Referenca e urdhëruesit / Ordering reference number	FT26140CF9R6
Adresa / Address	AKTASH AGIM RAMADANI BUILDING NO 51

Të dhënat e përfituesit / Beneficiary details

Emri i përfituesit / Beneficiary name	Organi Shqyrtues i Prokurorimit / Procurement Review Body
Numri i llogarisë së përfituesit / Beneficiary account number	1501001010282577

Të dhënat e transaksionit / Transaction details

Shuma / Amount	9,600.00
Monedha / Currency	EUR
Kursi i këmbimit / Exchange rate	1.0000
Përshkrimi i pagesës / Payment description	Tarifa e Ankimimit per Aktivitetin: KEK-26-1179-1-1-1 - Furnizim me pjese nderrimi dhe servisimi per meka
Komisioni / Commission	0
Data / Date	20/05/2026
Kanali i pagesës / Payment channel	imBanking
Statusi i pagesës / Payment status	Ekzekutuar / Executed



Rifreskoni kontaktet tuaja! Nëse ndryshoni kontaktet tuaja (numër telefoni, adresë), vizitoni degën Raiffeisen më të afërt për ti rifreskuar ato. Vetëm përmes numrit të telefonit dhe adresës suaj të saktë, ne mund t'ju mbajmë të informuar për çdo ofertë, ndryshim apo produkt/shërbim bankar.

Update your personal and contact details (phone number, address) if they changed since your last update, by visiting the nearest branch of Raiffeisen Bank. Updated contact details allow us to keep in touch with you in real time on new offers, important notice and our products&services.

Kontakti +383 38 222 222 • info@raiffeisen-kosovo.com • www.raiffeisen-kosovo.com

Adresa: Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C., str. Robert Doll #99 10000 Prishtinë, Kosovë • Swift: RBKOKPR • IBAN: XK05



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOSOVËS / SKUPŠTINA KOSOVA / ASSEMBLY OF KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PROCUREMENT REVIEW BODY



UNIREF

PAGESE PËR DEPOZITË PËR SIGURIM TË ANKESËS
PLAĆANJE ZA SIGURNOST DEPOZITA ŽALBE
PAYMENT FOR THE SECURITY DEPOSIT OF THE COMPLAINT



PPQDD11111111111H

Të dhënat e OE
Podaci EO
EO data

Bahri Asllani B.I - N.T.SH Ekoinvest, RR. Agim Ramadani, Aktash C1/9, 10000 Prishtine

Përshkrimi
Opis
Description

Furnizim me pjesë ndërrimi dhe servisimi për mekanizmin e rëndë Komatsu

Numri i prokurimit
Broj nabavke
Procurement number

KEK-26-1179-1-1-1

Shuma / Iznos
Ammount

€ 9600 Euro 00 Ct Data / Datum / Date 200526

Me fjalë / Reçima
In words

Xhirollogaria
Broj žiroračuna
Bank account

1000430070005756

Lëshuar nga
Izdato od /
Issued by

OSHP

Nënshkrimi dhe vula e bankës
Potpis i pečat banke
Bank signature and stamp

14.2 Ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, të gjithë ankuesit duhet të paguajnë një tarifë të ankesave në OSHP.

a. Kurdo që ankesa ndërlihet me vendimin për shpërblim të një kontrate, shuma e tarifës së ankesës është e barabartë me një përqind (1%) të vlerës së ofertës, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5,000 Euro.

b. Kurdo që aneksa ndërlihet me njoftimin për kontratë, dokumentet e tenderit, shuma e tarifës së ankesës është e barabartë me një përqind (1%) të vlerës së parashikuar, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5,000 Euro.

14.2 U skladu sa članom 118 ZJN, svi podnosioci žalbe moraju platiti žalbu u TRN.

a. Kad god se žalba odnosi na odluku o dodeli ugovora, iznos žalbene naknade iznosi jedan procenat (1%) od vrijednosti ponude, ali ne manje od 100 € i ne više od 5.000 €.

b. Kad god se aneks odnosi na obaveštenje o ugovoru, tenderska dokumentacija, iznos naknade za žalbu iznosi jedan procenat (1%) od procenjene vrednosti, ali ne manje od 100 evra i ne više od 5.000 evra.